

VENDIM
Nr.697, datë 11.10.2006

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR.73, DATË 4.2.2005 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË DELVINË TË PRONËS NR.638 “ISH-BRIGADË KËMBËSORIE”, NË RUSAN, DELVINË, E CILA ËSHTË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË MBROJTJES DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 14 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” dhe të neneve 121 e 124 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit nr.73, datë 4.2.2005 të Këshillit të Ministrave “Për transferimin në pronësi të bashkisë Delvinë të pronës nr.638 “Ish-brigadë këmbësorie”, në Rusan, Delvinë, e cila është në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”.

2. Prona me nr.638 “Ish-brigadë këmbësorie”, në Rusan, Delvinë, të shtohet në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes, miratuar me vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, bashkia e Delvinës dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha